

NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDRËVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#103

MEMORANDUMI/ Bashkëpunim dhe promovim mes të rinjve në Shqipëri dhe Diasporë



Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe ajo e Rinisë kanë firmosur një memorandum bashkëpunimi për nxitjen e bashkëpunimit për mbrojtjen dhe promovimin e të rinjve të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të rinjve shqiptarë në diasporë.

Memorandumi është firmosur nga drejtoresha ekzekutive e AKD-së, znj. Sonila Hysi dhe drejtoresha e përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, znj. Kleina Kasana.

Nëpërmjet këtij memorandumi këto dy institucione do të bashkëpunojnë për Dhënien e mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes të të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integritit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve.



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

VOTA/ Ministri Pandeli Majko: Diaspora, të ketë qark të vetin elektorale

Ministri i Shtetit për Diasporën Pandeli Majko thotë se shqiptarët jashtë vendit duhet të kenë një qark të vetin elektorale, pasi jemi rasti i rrallë ku gjysma e popullsisë jeton jashtë vendit.

“Diaspora duhet të ketë një qark elektorale të veçantë, pasi ashtu siç është vota do shpërndahet dhe nuk ka pasur element sinjifikativ të vlerësimit të tyre si opinion politikbërës nga jashtë vendit. Duke pasur një qark elektorale, do të jenë një zë. Jemi një rast i rrallë që kemi gati gjysmën e popullsisë jashtë vendit. Do të ketë interes të shtuar nëse do të kishim një qark të tillë. Kini parasysh që kemi bërë reformë në kushtet e presionit të madh se s’kemi pasur opozitën kryesore në Parlament”, tha Majko.



Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

QBD/“Tregime të moçme shqiptare”, falas online botimi dygjuhësh shqip-italisht



Legjendat e Mujit, Halilit, Gjergj Elez Alisë, Ymer Agës, Kështjellës së Rozafës etj tani do të flasin edhe në gjuhën italiane falë projektit të Qendrës së Botimeve për Diasporën “Kuteli në pesë gjuhë”. Sot QBD ka publikuar falas online botimin dygjuhësh shqip-italisht, një përmbledhje të “Tregime të moçme shqiptare”, përkthyer nga Eugenio Scalabrino dhe redaktuar nga Renata Martini në gjuhën italiane.

Këto tregime dhe përralla do të shërbejnë për zgjerimin e njohurive, marrjen e informacionit dhe kultivimin e dijeve të nxënësve në Diasporë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën amtare. Ky botim shërben edhe si tekst ndihmës për shkollat në Diasporë, me qëllim thellimin e njohurive të tyre mbi gjuhën shqipe.



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"




Diaspora Shqiptare

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS

App store: këtu Play store: këtu

Digjitalizimi i Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen



CONNECT ALBANIA

Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online